



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL

Peleshi: Ipar, një proces transparent për të çuar mbështetjen atje ku duhet

2018-04-16 11:08:00



Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, z. Niko Peleshi ka zhvilluar sot një takim në fshatin Laknas, të qarkut të Tiranës, për të informuar fermerët dhe për t'u ofruar asistencën e duhur për skemat e programit IPARD. Në takim, ministri ka njoftuar dhe më parë çelja e "Thirrjes së parë" për aplikime për financime, subvencione dhe grante që ky program do të japë për bujqësinë shqiptare, do të bëhet në fillim të muajit Maji. Gjatë takimit ku ishin të pranishëm edhe përfaqësues të organizatave anëtare të Këshillit të Agrobiznesit Shqiptar, ministri Peleshi u shpreh se për të bërë këtë program është një proces, që kërkon në radhë të parë njëpunë të detajuar sqaruese, që duhet bërë me mundësisht personalisht, me të gjithë ata që janë të interesuar, me qëllim kthimin e besimit për të gjithë pjesëmarrës për aplikimet dhe përfitimet nga këto skema.

Më tej z. Peleshi është shprehur se një rëndësi e veçantë i është dhënë transparencës me të cilën do të zhvillohet ky proces, i cili do të vazhdojë të jetë i tillë dhe gjatë vlerësimit dhe përzgjedhjes së fituesve.

"Paratë janë, por na duhet t'i çojmë tek përfituesit. Rruga nga dëshira dhe deri tek përfitimi, kalon së pari përmes qartësisë së idesë, pastaj kthimi i kësaj ideje në projekt, pastaj plotësimi i projektit me gjithë të dhënat që kërkon ky program i IPARD-it, aplikimi dhe padyshim, pastaj procesi i vlerësimit. Është detyra jonë, që të jetë edhe më transparent edhe më i shpejtë, edhe më i mbrojtur nga fenomenet, të cilat nuk kanë munguar në të kaluarën. Ne besoj se kemi bërë hapa të rëndësishëm drejt rritjes së transparencës, madje në skemën kombëtare, që është tashmë në proces, mbyllet në datën 27 prill aplikimet për skemën kombëtare të granteve dhe subvencionit. Çuam në zero burokracinë, për subvencionet, për pagesat direkte."

Duke përfituar nga ky takim, ministri Peleshi ka bërë të njohur dhe incentivën që pritet të miratohet për Shtetëzimin e Bashkëpunimit Bujqësor, duke i përjashtuar nga TVSH-ja, e njëjta praktikë ndiqet dhe për fermerët e vegjël.